

Vendim nr. 199 datë 24.09.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Fiona Papajorgji,	Anëtare
Marjana Semini,	Anëtare

në datën 24.09.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 26 (A) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: **ARDITA HARXHI**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-213, datë 31.01.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 15, pika 1, 16, pika 2, 18, pika 1, 43, 49, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Holta Zaçaj, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja prej vitit 2009 ka qenë e përfshirë në marrëdhënie bashkëpunimi me shoqërinë “LR Health & Beauty Systems” sh.p.k. (*shoqëria LR*), e cila ushtron veprimtari në fushën e shitjes së produkteve të shëndetit, kozmetikës etj. Ajo fillimisht ka pasur funksionin e bashkëpunëtores së thjeshtë dhe më pas atë të lideres, të materializuar në kontratën pa afat të caktuar të emërtuar “Kontratë për lider organizativ”, të lidhur në datën 11.11.2011.

2. Në datën 13.09.2013 shoqëria LR i ka njoftuar kërkueses ndërprerjen e marrëdhënieve të partneritetit dhe të kontratës së liderit organizativ. Kërkuesja, duke e konsideruar zgjidhjen e kontratës së njëanshme pa shkaqe të përligjura dhe pa respektuar afatin e njoftimit ka ngritur padi në gjykatë për shpërblimin e dëmit pasuror (humbje e pësuar dhe fitim i munguar) dhe të dëmit jopasuror për shkak të dëmtimit të shëndetit dhe imazhit të saj. Ndërkohë edhe shoqëria LR ka paraqitur kundërpadi.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1277, datë 23.02.2015, ka vendosur rrëzimin e padisë dhe të kundërpadisë, me arsyetimin se ato ishin të pambështetura në ligj dhe në prova. Për sa i takon rrëzimit të padisë, gjykata ka arsyetuar se edhe pse zgjidhja e kontratës ka qenë e menjëhershme dhe pa njoftim paraprak, ajo ka ndodhur për shkaqe të drejta dhe të justifikuar që kanë të bëjnë me shkelje/mospërbushje të detyrimeve kontraktore nga ana e kërkueses, e cila ka pezulluar aktivitetin në mënyrë të njëanshme dhe pa njoftim. Ndërsa lidhur me kundërpadinë, gjykata ka argumentuar se nuk e ka vlerësuar të drejtë gjorbitjen e kërkueses, pasi mospërbushja e detyrimeve kontraktore ka sjellë si pasojë zgjidhjen e kontratës.

4. Mbi ankimin e palëve ndërgjyqëse Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2190, datë 05.11.2015, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, pasi ka arsyetuar se pretendimet e paraqitura në ankim nga palët ndërgjyqëse nuk ishin të bazuara, në kushtet kur me të drejtë gjykata ka konkluduar në rrëzimin e padisë dhe të kundërpadisë. Kundër këtij vendimi kanë ushtruar rekurs të dyja palët.

5. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-213, datë 31.01.2024, ka vendosur mospranimin e rekurseve me argumentin se ishin bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikohen në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*), sipas formulimit që ka pasur në kohën e paraqitjes së tyre.

6. Në datën 31.05.2024 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesën sipas objektit, e cila, pasi është plotësuar me dokumentet e kërkuara, bazuar në nenin 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 26.06.2024.

II

Pretendimet e kërkueses

7. **Kërkuësja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimi i kundërshtuar i ka cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

- 7.1. *Parimit të kontradiktoritetit, së drejtës për t'u mbrojtur dhe dëgjuar*, pasi nuk i është dhënë mundësia të argumentojë shkaqet e rekursit dhe se Gjykata e Lartë nuk ka analizuar nëse kanë ekzistuar ose jo shkaqet e justifikuara për ndërprerjen e kontratës dhe shkatërrimin e një rrjeti bashkëpunëtorësh prej 5000 vetash. Asaj nuk i është garantuar e drejta për t'u dëgjuar, për t'u mbrojtur dhe për të parashtruar fakte dhe prova brenda një afati të arsyeshëm, duke iu ndërprerë marrëdhënia me të gjithë rrjetin e ngritur prej saj.
- 7.2. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi Gjykata e Lartë duhej ta kishte kaluar çështjen në seancë plenare me praninë e palëve për të njësuar praktikën gjyqësore lidhur me sistemet *multi level marketing* që tashmë janë prezente mjaftueshëm në territorin shqiptar. Qëndrimi i Gjykatës së Lartë i ka cenuar pritshmëritë për ndryshimin e një situatë të pafavorshme ligjore ndaj saj.
- 7.3. *Parimit të ligjshmërisë*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka analizuar veprimet e shoqërisë për ndërprerjen e marrëdhënies së bashkëpunimit, njoftimit, afatet dhe shkaqeve referuar kontratës së datës 11.11.2011. Për shkak të mosrespektimit të kontratës edhe njoftimi për ndërprerjen e saj është i pavlefshëm.
- 7.4. *Së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, pasi ka 11 vjet që pret gjykimin e çështjes, nga të cilat 9 vjet pritje në Gjykatën e Lartë, e cila në përfundim është shprehur me vendim mospranimi.
- 7.5. *Parimit të mosdiskriminimit*, pasi nëse Gjykata e Lartë do ta kishte shqyrtuar çështjen në seancë plenare me praninë e palëve do të kishte konstatuar se ndërprerja e marrëdhënieve të bashkëpunimit ka qenë pa shkak ligjor, por thjesht vullnet i drejtuesit rajonal të kompanisë i shtyrë nga motive konkurrencte të pandershme brenda kompanisë.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkueses

8. Çështja e legjitimitit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Kolegji çmon se kërkuësja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, sepse ka qenë palë në procesin gjyqësor ku është dhënë vendimi i kundërshtuar dhe ka interes të drejtpërdrejtë për çështjen e parashtruar.

10. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar. Në nenin 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, përmbushja e këtij kriteri është detajuar në dy hipoteza: i) kur kërkuesi ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive përpara se t’i drejtohet Gjykatës; ii) kur legjislacioni i brendshëm nuk parashikon mjete efektive në dispozicion.

11. Kolegji vëren se kërkuësja, ndër të tjera, ka pretenduar se ka 11 vjet që pret gjykimin e çështjes, nga të cilat 9 vjet pritje në Gjykatën e Lartë, e cila në përfundim shprehet me vendim mospranimi. Për sa i takon kohëzgjatjes së shqyrtimit të çështjes, përfshirë edhe shqyrtimin e rekursit në Gjykatën e Lartë, dispozitat e KPC-së (nenet 399/1 – 399/12) që kanë hyrë në fuqi në nëntor 2017, parashikojnë mjetet juridike për t’u mbrojtur nga cenimi i së drejtës për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm. Kjo do të thotë se ligji procedural i garanton individit mbrojtje efektive lidhur me gjykimin e çështjes së tij brenda një afati të arsyeshëm. Në rastin konkret, ndonëse kërkuësja ka pretenduar se shqyrtimi i saj në Gjykatën e Lartë ka zgjatur 9 vjet, nuk rezulton që ajo t’i jetë drejtuar asaj gjykate me ndonjë kërkesë për përshpejtimin e shqyrtimit të rekursit dhe/ose konstatimin e gjykimit të çështjes tej afatit të arsyeshëm, sipas nenit 399/6, pika

1, shkronja “c”, të KPC-së. Në këto rrethana, kërkuesja nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, ndaj ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

12. Ndërsa, për sa u takon pretendimeve të tjera që lidhen me cenimin nga Gjykata e Lartë të së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspektet e së drejtës për t’u mbrojtur dhe dëgjuar, si dhe parimeve të kontradiktoritetit, sigurisë juridike, të ligjshmërisë dhe mosdiskriminimit, Kolegji vlerëson se kërkuesja nuk ka mjete të tjera përveç ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ajo i ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion.

13. Gjithashtu, kërkuesja legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë mban datën 31.01.2024 dhe ankimi kushtetues individual është dërguar përmes shërbimit postar në datën 31.05.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000.

14. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuesja ka pretenduar cenimin e procesit të rregullt ligjor në aspektet e së drejtës për t’u mbrojtur dhe dëgjuar dhe parimeve të kontradiktoritetit, sigurisë juridike, të ligjshmërisë dhe mosdiskriminimit, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës.

15. Lidhur me pretendimin për cenimin e *parimit të sigurisë juridike*, kërkuesja ka argumentuar se Gjykata e Lartë duhej të kishte kaluar çështjen në seancë plenare me praninë e palëve për të njëzuar praktikën gjyqësore lidhur me sistemet *multi level marketing* që tashmë janë prezente mjaftueshëm dhe prej vitesh në territorin shqiptar. Sipas kërkueses, qëndrimi i Gjykatës së Lartë i ka cenuar pritshmëritë për ndryshimin e një situate të pafavorshme ligjore ndaj saj. Kolegji vë në dukje se Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar rëndësinë e parimit të sigurisë juridike, i cili nënkupton, mes të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit te shteti, institucionet e tij dhe aktet që ato nxjerrin (*shih vendimet nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 50, datë 03.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa u përket të drejtave të fituara, si element i këtij parimi, Gjykata ka pohuar se siguria juridike nënkupton se kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim (*shih vendimet nr. 10, datë 13.02.2017; nr. 23, datë 08.06.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin në shqyrtim, Kolegji konstaton se kërkuesja nuk është ndodhur në kushtet e ndonjë të drejte të fituar, qoftë edhe me vendim gjyqësor të formës së prerë, gjë e cila mund ta vendoste atë në pozitat e pritshmërive të ligjshme. Nga ana tjetër, fakti se tashmë sistemet *multi level marketing* janë prezent prej vitesh në territorin shqiptar dhe se për këtë arsye Gjykata e Lartë duhej të njëzonte praktikën lidhur me to, nuk mund të shërbejë si argument kushtetues në funksion të pretendimit për cenimin e parimit të sigurisë juridike. Për

rrjedhojë, ky pretendim nuk është ngritur në nivel kushtetues dhe, si i tillë, nuk mund të merret në shqyrtim.

16. Kërkuësja ka pretenduar cenimin e parimit të kontradiktoritetit dhe së drejtës për t'u mbrojtur e dëgjuar, si dhe parimin e ligjshmërisë dhe diskriminimit, duke argumentuar, në mënyrë të përmbledhur, se Gjykata e Lartë duhej ta gjykonte çështjen në seancë gjyqësore me praninë e palëve, se ndërprerja e marrëdhënieve të bashkëpunimit ka qenë pa shkak ligjor dhe asaj nuk i është garantuar e drejta për t'u dëgjuar, për t'u mbrojtur dhe për të parashtruar fakte dhe prova. Mbështetur në thelbin e këtyre argumenteve, Kolegji çmon t'i analizojë pretendimet e kërkuëses, në këndvështrim të së drejtës për t'u mbrojtur dhe dëgjuar të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, të cilat *prima facie* janë me natyrë kushtetuese dhe hyjnë në juridiksionin e kësaj Gjykate.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u mbrojtur dhe për t'u dëgjuar të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

17. Kërkuësja ka pretenduar se Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë mundësinë të argumentojë shkaqet e rekursit dhe se Gjykata e Lartë nuk ka analizuar nëse kanë ekzistuar ose jo shkaqet e justifikuara për ndërprerjen e kontratës dhe shkatërrimin e një rrjeti bashkëpunëtorësh prej 5000 vetash. Asaj nuk i është garantuar e drejta për të parashtruar fakte dhe prova, duke iu ndërprerë marrëdhënia me të gjithë rrjetin e ngritur prej saj. Po kështu, ka argumentuar kërkuësja, Gjykata e Lartë nuk ka analizuar veprimet e shoqërisë për ndërprerjen e marrëdhënies së bashkëpunimit, njoftimit, afatet dhe shkaqeve referuar kontratës së datës 11.11.2011. Për shkak të mosrespektimit të kontratës edhe njoftimi për ndërprerjen e saj është i pavlefshëm. Nga ana tjetër, sipas kërkuëses, nëse Gjykata e Lartë do ta kishte shqyrtuar çështjen në seancë plenare me praninë e palëve do të kishte konstatuar se ndërprerja e marrëdhënieve të bashkëpunimit ka qenë pa shkak ligjor, por thjesht me vullnetin e drejtuesit rajonal të kompanisë, i shtyrë nga motive konkurrencte të pandershme brenda kompanisë.

18. Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar se e drejta për t'u dëgjuar, në unitet edhe me të drejta të tjera, ka për qëllim garantimin e një procesi gjyqësor ku individit i krijohen mundësitë që, përpara marrjes së vendimit gjyqësor, të dëgjohet realisht për thelbin e çështjes. Nëpërmjet pjesëmarrjes dhe krijimit të kushteve për t'u dëgjuar, individëve u krijohen mundësi të barabarta për deklaratimet e tyre, për parashtrimin e fakteve, provave e vlerësimeve ligjore. Kjo e drejtë realizohet edhe përmes shqyrtimit të dokumenteve, pra mbi komentet dhe shpjegimet e dhëna me

shkrim nga palët ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 43, datë 27.12.2022; nr. 41, datë 22.12.2022; nr. 38, datë 02.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Për sa i takon standardit kushtetues të arsytimit të vendimit gjyqësor, Gjykata ka theksuar se ai është element thelbësor i një vendimi të drejtë që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 14, datë 21.03.2023; nr. 3, datë 20.01.2017; nr. 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, Gjykata është shprehur se vlerësimi nëse çështja duhej të shqyrtohej në dhomën e këshillimit ose në seancë publike u përket vetë kolegjeve të Gjykatës së Lartë dhe shqyrtimi i çështjes në dhomën e këshillimit nuk është vetëm një konstatim formal i paraqitjes së shkaqeve ligjore në rekurs, por konsiston në vlerësimin e këtyre shkaqeve dhe bazueshmërinë e tyre, duke analizuar materialet e dosjes gjyqësore (*shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 8, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Nga ana tjetër, në kontekstin kushtetues, vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të çështjes, si dhe interpretimi i ligjit nuk mund të jenë objekt i gjykimit kushtetues, pasi ato janë në kompetencë të gjykatave të sistemit gjyqësor të zakonshëm, por Gjykata çmon nëse ato (gjykatat) kanë respektuar të drejtat e palëve në gjykim dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes (*shih vendimin nr. 41, datë 22.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Kolegji vëren se kërkuësja është përfshirë në marrëdhënie bashkëpunimi me shoqërinë LR dhe në vijim të ecurisë së angazhimit të saj ajo ka arritur të fitojë titullin lider organizativ pranë kësaj shoqërie, formalizuar me kontratën e datës 11.11.2011. Sipas kontratës, lideri organizativ është një person fizik i pavarur, i cili blen ose shet produktet e shoqërisë në emër dhe për llogari të tij, si dhe ndërmjetëson për gjetjen e partnerëve të rinj. Ai nuk është punonjës i shoqërisë (*neni 1*). Në nenin 11 të kontratës parashikohet se palët kanë të drejtë të ndërpresin marrëdhëniet profesionale nëse respektojnë afatet dhe kontrata u përshtatet rregullave dhe ligjeve shqiptare, veçanërisht nenit 935 e në vazhdim të Kodit Civil, ndërsa zgjidhja e mosmarrëveshjeve është nën juridiksionin e gjykatave shqiptare. Në datën 13.09.2013, administratori i shoqërisë i ka njoftuar kërkuëses ndërprerjen e marrëdhënieve të bashkëpunimit përfshirë edhe kontratën e datës 11.11.2011 me motivacionin se kërkuësja me veprimet e saj ka shkelur në mënyrë të përsëritur detyrimet e parashikuara në kontratë të lidhura me shpifje, përgojime ndaj reputacionit të shoqërisë dhe joshjen e bashkëpunëtorëve në favor të një shoqërie tjetër, të cilat kanë sjellë edhe ndërprerje

në mënyrë të pakthyeshme të besimit. Në datën 18.09.2013 kërkuesja i është kundërpërgjigjur shoqërisë, duke e konsideruar ndërprerjen e marrëdhënieve të njëanshme dhe arbitrare.

22. Më tej, kërkuesja i është drejtuar me padi gjykatës së Tiranës, e cila e ka rrëzuar atë, duke arsyetuar, në mënyrë të përmbledhur, se pozita si lider organizativ nuk është e përhershme, por e kushtëzuar nga plotësimi i kriterëve të përcaktuara shprehimisht, mosplotësimi i të cilave passjell dhe humbjen e titullit. Ajo gjykatë, pasi ka analizuar çështjen ka çmuar se zgjidhja e kontratës së bashkëpunimit dhe në veçanti e asaj për liderin organizativ është bërë për shkaqe të drejta, të arsyeshme që kanë të bëjnë me shkelje/mospërmbushje të detyrimeve kontraktore të kërkueses. Ky vlerësim i gjykatës së shkallës së parë është konfirmuar edhe nga gjykata e apelit, e cila ka arsyetuar se nga shqyrtimi i provave ka rezultuar e provuar se kërkuesja me veprimet e saj ka shkelur kontratën e lidhur me palën e paditur. Sipas asaj gjykate, pezullimi i aktivitetit në mënyrë të njëanshme nga kërkuesja me të drejtë është konsideruar nga gjykata e faktit si mospërmbushje e detyrimeve kontraktore, gjë e cila në vetvete është bërë shkak për zgjidhjen e kontratës së bashkëpunimit mes palëve ndërgjyqëse. Sipas gjykatës së apelit, në asnjë rast pala paditëse nuk mund të vendoste dhe aq më tepër në mënyrë të njëanshme pezullimin e aktivitetit të punës, duke shkelur në këtë mënyrë të drejtat që burojnë nga kontrata. Në përfundim, edhe gjykata e apelit ka konkluduar se kërkuesja ka vepruar në shkelje të detyrimeve kontraktuale, për rrjedhojë padia e ngritur nga ana e saj nuk gjen mbështetje në ligj dhe në prova.

23. Në vijim, shkaqet e ngritura në rekurs nga kërkuesja dhe shoqëria LR janë marrë në shqyrtim në dhomën e këshillimit nga Gjykata e Lartë, e cila ka vlerësuar se rekursi është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato të përcaktuara në nenin 472 të KPC-së. Sipas saj, gjykatat e faktit nuk kanë lejuar shkelje procedurale, kanë respektuar ligjin material, duke e interpretuar dhe zbatuar drejt atë dhe vendimet e dhëna prej tyre nuk vinin në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Civil ose Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Ndërsa pjesa e pretendimeve në rekurs që ngre çështje të vlerësimit të provave, del jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë (*shih paragrafët 25 dhe 26 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

24. Në analizë të akteve të dosjes gjyqësore dhe përmbajtjes së vendimeve gjyqësore, përfshirë edhe atë të Gjykatës së Lartë, Kolegji konstaton se çështja e kërkueses në shkallë të parë dhe në apel është shqyrtuar në seancë gjyqësore me pjesëmarrjen edhe të avokates së përzgjedhur prej saj. Përgjatë gjykimit kërkuesja ka pasur mundësi të paraqesë pretendime, argumente, dokumente dhe akte në cilësinë e provës, të dëgjohet dhe të mbrohet, si personalisht ashtu edhe nëpërmjet përfaqësueses së saj. Nga ana tjetër, gjykimi në Gjykatën e Lartë i zhvilluar në dhomën

e këshillimit është vënë në lëvizje nga rekursat e palëve, përfshirë edhe atë të kërkueses. Ndërkohë rekursi i palës tjetër i është njoftuar kërkueses me dëftesën e komunikimit nr. 1277, datë 11.12.2015, që do të thotë se ajo ka pasur mundësi të njihet në kohë me shkaqet e rekursit të palës kundërshtare. Sipas njoftimit publik të shpallur në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë dhe në këndin e njoftimeve në datën 15.01.2024, çështja e kërkueses është planifikuar për t'u shqyrtuar në seancën e datës 31.01.2024. Në vijim të njoftimit të palëve, Gjykata e Lartë ka marrë në shqyrtim rekursat duke disponuar me mospranimin e tyre. Vendimi i asaj gjykate, megjithëse me arsyetim të kufizuar, përmban të dhënat e palëve, arsyetimin e përmbledhur të gjykatave më të ulëta, shkaqet dhe argumentet e paraqitura në rekursat e të dyja palëve, ligjin e zbatueshëm, si dhe vlerësimin për shkaqet e rekursit në raport me procesin e zhvilluar në gjykatat më të ulëta.

25. Për sa më lart, Kolegji çmon se në të kundërt nga sa pretendon kërkuesja, ajo i ka pasur të gjitha mundësitë të ushtrojë të drejtën e mbrojtjes të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar nëpërmjet paraqitjes së rekursit, marrjes dijeni të shkaqeve të rekursit të palës kundërshtare dhe njoftimit për shqyrtimin e rekurseve, ndërsa shqyrtimi i rekursit në dhomën e këshillimit është një çështje e mënyrës së zbatimit të ligjit nga Gjykata e Lartë, e cila në rastin konkret nuk rezulton t'i ketë sjellë kërkueses ndonjë pasojë në të drejtat e saj. Nga ana tjetër, çmuarja e fakteve, provave dhe rrethanave të çështjes, si dhe interpretimi i ligjit për sa u përket shkaqeve të (pa)ligjshme të ndërprerjes së marrëdhënieve të bashkëpunimit ndërmjet palëve përfshihet në juridiksionin e gjykatave të zakonshme, të cilat kanë dhënë shpjegimin dhe vlerësimin e tyre për mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi. Gjithashtu, Gjykata e Lartë ka arsyetuar mjaftueshëm vlerësimin e saj lidhur me bazueshmërinë e shkaqeve të rekurseve (*shih paragrafët 24 – 27 të vendimit të Gjykatës së Lartë*), gjë e cila konfirmon se kërkuesja është dëgjuar nga ajo gjykatë përmes shqyrtimit të dokumenteve. Nën dritën e këtyre rrethanave, pretendimet e kërkueses janë haptazi të pabazuara.

26. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.